

# Përse RE/MAX?

MUNDËSI QË VJEN VEÇ NJËHERË NË JETË



**RE/MAX**

**BËHU PJESË  
E NJË RRJETI  
TË SUKSESSHËM!**





# BOTA E RE/MAX

## **RE/MAX përfaqëson sistemin më të suksesshëm franchise në tregun ndërkombëtar imobiliar.**

RE/MAX është sot sistemi më i suksesshëm franchise në tregun ndërkombëtar të pronave të paluajtshme. Që prej themelimit të tij në vitin 1973 në Denver, Kolorado të Shteteve të Bashkuara, rrjeti RE/MAX është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Sot RE/MAX numëron mbi 7,000 zyra dhe 90,000 Partner Shitje të cilët operojnë në mbi 80 shtete. Në Europë ne prezantohemi me më shumë se 11,232 Partner Shitje e mbi 1,548 zyra me moton: "Në biznes për vete, por jo i vetëm!"


Franchisee i RE/MAX është operatori dhe pronari i zyrës, i njohur si Broker. Duke ju ofruar Brokerave dhe Partnerëve të Shitjes teknologjinë më të fundit, strategji efektive marketingu, dhe aftësi krijuese shitjesh, sistemi RE/MAX rrit ndjeshëm të ardhurat e aktivitetit tuaj dhe ju pozicionon në treg si lider të pakrahasueshëm.

Modeli i biznesit tonë franchise thekson se suksesi i Brokerit lidhet drejtpërdrejt me aftësinë për të rekrutuar dhe organizuar një ekip agjentësh të trajnuar mirë, të cilët e pëlqejnë sfidën dhe duan të veprojnë në mënyrë të pavarur. Ky sistem i provuar biznesi bën që agjensitë RE/MAX të kenë një avantazh konkures mbi sistemet e tjera si pasojë e sinergjisë së rrjetit ku një numr i madh sipërmarrësish punojnë së bashku për të realizuar më lehtësisht objektivat profesionale, ruajnë cilësinë, dhe ulin koston e shërbimit.

Vizioni ynë synon bashkëpunimin profesional me të gjithë anëtarët e rrjetit dhe operatorët e industrisë së pasurive të paluajtshme. Ky bashkëpunim e vendos klientin në qendër të vëmendjes dhe i shërben ekskluzivisht interesave të tij.

RE/MAX është zgjedhja e duhur për të ardhmen e karrierës suaj. Qëllimi jonë është të asistojmë partnerët tanë lokal, kudo ku ndodhen, në ndërtimin e një modeli të sigurtë e të suksesshëm biznesi. Për këtë qëllim përgatitëm këtë broshurë, për t'ju prezantuar më gjerësisht me konceptin e RE/MAX dhe arsyet kryesore përse me RE/MAX fitojnë të gjithë.

**Sinqerisht,**



**Elona Sopiçoti,**

Regional Director  
RE/MAX Albania



# “Tregu lokal i pasurive të paluajtshme në rajonin tim është shumë i ndryshëm. Si mund të funksionojë koncepti RE/MAX në Shqipëri?”



**Njerëzit kudo në botë ndajnë një nevojë të përbashkët;** nevojën e domosdoshme për të patur një shtëpi. Atyre ju nevojiten këshilla profesionale gjatë blerjes ose shitjes së pronave të tyre.

Qindra mijëra transaksione të pronave të paluajtshme kryhen çdo vit anembanë botës me ndërmjetësimin e agjentëve profesionistë. Megjithatë ende një numër i konsiderueshëm individësh shesin dhe blejnë prona pa angazhuar agjentët lokal. Shpeshherë kjo ndodh për arsye se klientët nuk besojnë se çmimi që u paguhet agjentëve i përgjigjet cilësisë së shërbimit të premtuar.

Ndërkohë që jeta e njerëzve është vazhdimisht në ndryshim. Partnerët e Shitjes së RE/MAX qëndrojnë në kontakt të vazhdueshëm me klientët e tyre dhe u shërbejnë nevojave specifike që ata kanë.

Partnerët tanë të Shitjes investojnë në krijimin e një

marrëdhënie të përhershme me klientin. Bashkëpunimi është pjesë integrale e konceptit tonë RE/MAX, ndaj dhe komunikimi i hapur dhe i vazhdueshëm me klientët bën që agjentët e RE/MAX të kryejnë më shumë transaksione, si rezultat i referencave të mira.

Ne punojmë në shërbim të interesit më të mirë të klientit. Standardet e praktikave tona udhëhiqen nga Kodi i Etikës së RE/MAX i cili mbulon sjelljet e anëtarëve të rrjetit në lidhje me transaksionet, marrëdhënien me klientët, dhe aktorët e tjerë të tregut të pasurive të paluajtshme.

RE/MAX ofron infrastrukturën dhe sistemin e nevojshëm operativ i cili i mundëson Partnerit të Shitjes dhënie të një shërbimi të një cilësie të lartë e konform standardeve ndërkombëtare. Ndër të tjera, eksperiencia e akumuluar ndër vite e rrjetit RE/MAX ka ndikuar në ndërtimin e imazhit të një partneri të besueshëm tek i cili klientët gjejnë qëndrueshmërinë e një shërbimi profesional dhe etik.

RE/MAX është këtu për t'ju mbështetur në ndërtimin e biznesit tuaj.



## PËRGJITHMONË KLIENT

# “E kuptoj që koncepti i RE/MAX dhe përbërësit e tij mund të përshtaten lehtësisht në tregun tim lokal, por unë nuk jam një rekrutues i mirë. Si mund të më ndihmojë RE/MAX në mënyrë që agjentët profesionistë t’i bashkohen kompanisë time?”

## **Rekrutimi efektiv** është më i lehtë nga sa mendoni.

Kur ju bëheni pjesë e rrjetit RE/MAX, agjentët tuaj ndjekin trajnime të avancuara pranë Akademisë së Real Estatit RE/MAX ku mësojnë parimet profesionale të një agjenti të suksesshëm.

Modeli RE/MAX i Zhvillimit të Karrierës (Career Development Model, CDM) i projektuar për Brokerat e rinj, përfshin module të tilla si:

- **Themelimi i Biznesit**
- **Master Plani për Rritjen e të Ardhurave dhe Administrim Fiskal**
- **Administrimi Operacional i Zyrës**
- **Teknikat e Rekrutimit**
- **Stimulimi dhe Zhvillimi i Aftësive të Partnerëve të Shitjes**
- **E ardhmja është në Duart Tuaj**

Për pronarët e rinj të zyrave Franchise, RE/MAX ofron kurse të veçanta trajnimi dhe mundësi intership-i pranë zyrave ekzistuese të RE/MAX më të suksesshme në Shqipëri dhe Europë, duke ju dhënë mundësinë partnerëve tanë të njihen nga afër me praktikat më të mira të zhvillimit të biznesit.

## **REKRUTIMI NË RE/MAX**


Proçesi i rekrutimit është përbërësi më i rëndësishëm i aktivitetit tuaj tregtar. Sfidat më të mëdha me të cilën përballen sipërmarrësit e Franchise është pikërisht evidentimi dhe angazhimi afatgjatë i Partnerëve të Shitjes. Rekrutimi efektiv kërkon lider të zotë, ndaj dhe objektivi ynë kryesor është t’ju udhëzojmë si të rekrutoni individë me aftësi të mira shitëse dhe t’i shndërroni ata në Agjentë të jashtëzakonshëm.

Programet e specializuara të trajnimit për Brokerat përfshijnë prezantimin e teknikave më të avancuara të rekrutimit, të cilat përmbledhen në gjashtë module kryesore:

- **Koncepti i Rekrutimit RE/MAX**
- **Fuqia e CDM, Succeed dhe Career Nights**
- **Rekrutimi përmes Kontakteve Personale**
- **Rëndësia e Intervistave**
- **Vlerëso Kandidatin dhe Konkludo**
- **Planifiko Performancën dhe Implemento**

RE/MAX Albania ofron gjithashtu workshop-e rekrutimi të organizuara në grupe të cilat kanë si qëllim perfeksionimin e aftësive rekrutuese të Brokerave dhe Manaxherëve të Zyrave Franchise si dhe maksimizimin e rezultateve të arritura.

**RE/MAX**  
*Akademi*



# FRANCHISE JUAJ RE/MAX

# “Cila është asistencë promovionale që RE/MAX i ofron zyrës Franchise dhe Partnerëve të Shitjes?”



**Marka RE/MAX** është një ndër markat më të njohura në botë dhe në Europë. Balona tri ngjyrëshe e RE/MAX është përdorur në të gjitha reklamata promovionale duke shërbyer si simbol i suksesshëm në tërheqjen e vëmendjes së klientit.

Me RE/MAX ju mundeni:

- Të ndërtoni biznesin tuaj duke përdorur fuqinë e markës në të gjitha promovimet, reklamata dhe fushatat e marketingut.
- Të krijoni dhe manaxhoni një marrëdhënie të vazhdueshme me publikun dhe median.
- Të përdorni burimet promovionale që RE/MAX disponon duke kursyer kështu kohën, parat dhe energjitë tuaja.

Portali online **RE/MAX Design** mundëson postera të ndryshëm, banner-a, video reklama, newsletters, formate të kartëvizitave, kartolina, si edhe çdo material tjetër që i vjen në ndihmë Brokerit për rekrutimin e Partnerëve të Shitjes, si dhe i ndihmon këta të fundit të promovojnë listimet e pronave në treg.

## **Shtypi dhe Marrëdhëniet me Publikun**

duhet të jenë pjesë integrale e planit tuaj të punës. RE/MAX ju udhëzon si të kombinoni strategjitë mediatike, marrëdhëniet me publikun dhe median sociale në promovimin e aktivitetit tuaj. Një program eficient i marrëdhënieve me publikun kërkon që ju të jeni aktiv në publikimin e lajmeve të rëndësishme nga industria e pasurive të paluajtshme, analiza të tregut, statistika, dhe të ndani me publikun informacione rreth eventeve të sponsorizuara nga RE/MAX.

## **Eventet e Sponsorizuara nga RE/MAX**

tërheqin një audiencë të gjerë ndërkombëtare. Reklamimi i vazhdueshëm i markës në evente të rëndësishme sportive të tilla si: UEFA Champions League, Formula 1 dhe Kupa Botërore e Kampionatit të Skive, ju ndihmojnë të jeni gjithmonë prezent në sytë e miliona shikuesve.

## **Konventat/Takimet/Eventet.**

RE/MAX zhvillon takime, trajnime të specializuara dhe konventa rajonale e ndërkombëtare me Drejtorët Rajonalë, Brokerat dhe Partnerët e Shitjes. Këto organizime i shërbejnë krijimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të një kulture të përbashkët pune. Ato gjithashtu ndikojnë në forcimin dhe në promovimin e vazhdueshëm të markës në tregun lokal.



# FUQIA E MARKËS

# “Si pronar i Franchise-it RE/MAX, roli im është të administroj dhe rekrutoj, por kush do t’i trajnojë Partnerët e mi të Shitjes?”

## Modeli i Zhvillimit të

**Karrierës** në RE/MAX është ndërtuar posaçërisht për t’iu shërbyer Partnerëve të Shitjes të cilët synojnë të ndërtojnë një karrierë të sigurtë e të gjatë profesionale. Ky model trajnimi disa javor, studion dhe nxjerr konkluzione të hollësishme mbi aspektet tregtare të pasurive të paluajtshme dhe shërbimeve të lidhura me to.

Pavarësisht eksperiencës dhe kualifikimeve të mëparshme të Partnerëve të Shitjes, zyra Rajonale nëpërmjet RE/MAX Real Estate Academy mundëson trajnimin fillestar dhe të avancuar të gjithë Partnerëve të Shitjes, për ti përgatitur ata në manaxhimin e çdo lloj transaksioni me standarde të larta profesionale.

## 1. RE/MAX DHE JU

Ky sesion orientimi një ditor fokusohet në analizimin e përgjithshëm të infrastrukturës Rajonale, konceptin dhe historikun e markës, Modelin e Zhvillimit të Karrierës, Kodi i Etikës dhe Teknologjia RE/MAX.

RE/MAX dhe JU është i hapur për tu ndjekur nga të gjithë ata që kanë dëshirë të informohen më tej rreth mundësive që ofron tregu i pasurive të paluajtshme dhe karriera me RE/MAX.

## 2. SUCCEED – TRAJNIMI I AGJENTËVE

Programi SUCCEED është një program interaktiv dhe ekskluziv i RE/MAX Academy. Ai i ofron Partnerëve të Shitjes mundësinë dhe mbështetjen e nevojshme nga zyrat Franchise për të gjeneruar menjëherë kontakte të vlefshme dhe të ardhura. Programi përgatitet dhe drejtohet nga mentor me eksperiencë brënda zyrës Franchise, i cili kujdeset për suksesin e Partnerëve të Shitjes.



# NJË RRUGË PËR KARRIERËN E AGJENTËVE



Programi SUCCEED zgjat gjashtë javë dhe orienton çdo Partner Shitje se si:

- Të gjenerojë interes tek klientë potencialë dhe më pas të hyjë në marrëdhënie tregtare me ta;
- Të evidentojë dhe nis më bisedime kontstruktive me blerës dhe shitës potencialë pronash;
- Të prezantoj pronat në publik dhe të organizoj evente open house
- Të adresojë shqetësimet e blerësve dhe të shitësve përmes ndërtimit të një bashkëbisedimi të efektshëm me ta;
- T'i paraqesë shitësit një plan të suksesshëm marketimi për pronën e tij;
- Të asistojë shitësin në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për shitjen e pronës;
- Të orientojë shitësin në përcaktimin e çmimit të pronës dhe në përllogaritjen e të ardhurave para dhe pas kryerjes së pagesës së tatim-taksave;
- Të përgatisë dhe prezantoj një ofertë shitje në përputhje me standardet më të larta profesionale;
- Të marrë pjesë aktive në negociimin e kushteve të kontratës në interes të klientit.

### 3.KARRIERA JUAJ NË RE/MAX

Pas përfundimit të programit SUCCEED, Partnerët e Shitjes mund të hedhin një hap të mëtejshëm në rrugën e zhvillimit të karrierës. Programi Karriera Juaj në RE/MAX është një prezantim akoma më i detajuar i biznesit të pasurive të paluatjshme në përputhje me mënyrën se si RE/MAX e sheh atë.

Motivimi individual, nuk mjafton për realizimin e suksesshëm të një detyrë profesionale. Partnerët e Shitjes së RE/MAX duhet të kenë aftësinë dhe mjeshtërinë e nevojshme për të përçuar vlera të vërteta në shërbimin ndaj klientit. Ne besojmë se mjeshtëria është mënyra më efektive për të dalluar një profesionist nga konkurrenca.

### 4.EDUKIM I VAZHDUESHEM

RE/MAX fton në evente të hapura publike disa prej trajnuesve më të mirë të industrisë së pasurive të paluatjshme në Amerikën e Veriut dhe në Europë, të cilët vazhdimisht prezantojnë programet e tyre përpara audiencave të mëdha ndërkombëtare. Ata së shpejti do të jenë të pranishëm dhe në Shqipëri. Çdo anëtar i rrjetit RE/MAX brenda dhe jashtë Rajonit përfiton automatikisht të drejtën e pjesëmarrjes në këto evente të rëndësishme ku dhe paraqiten të rejtat më të fundit të industrisë së pronave të paluatjshme.



# “Unë e di që sapo ti bashkohem rrjetit RE/MAX, unë jam në biznes për vete, por jo i vetëm. Kush do t’me asistojë në dhënien e konsultave të vazhdueshme në lidhje me këtë biznes?”

**RE/MAX asiston Franchise-në** në procesin e hapjes së zyrës dhe përgjatë operimit të saj. Ky është një proces sistematik i implementuar njëlloj në të gjithë Europën për të ndihmuar Brokerat me planifikimin e biznesit. Pranë zyrës Rajone të RE/MAX Albania, ju do të gjeni specialistët e Zhvillimit të Biznesit të cilët punojnë veçanërisht për t’ju mbështetur në fazën e parë të aktivitetit tuaj duke ju dhënë përgjigje pyetjeve të tilla si: Kush është vendi më i mirë për të hapur një zyrë RE/MAX? Ç’farë dizenjimi duhet të ketë zyra që të jetë sa më miqësore ndaj klientit? Cilat janë reklamat dhe aktivitetet më efikase për promovimin e zyrës Franchsie?

Biznesi plani juaj do të shikohet me kujdes nga specialistët tanë dhe në koordinim të ngushtë me ta ju do keni mundësinë të kryeni të gjitha përgatitjet paraprake për ditën e madhe të hapjes së zyrës suaj në publik.

Mbështetuni tek ekipi juaj RE/MAX në çdo kohë. Ndarja e praktikave më të mira të punës midis franchise-ve është një komponent integral që e bën rrjetin tonë akoma dhe më të fuqishëm.

Roli dhe dedikimi që ka RE/MAX është të lehtësoj jetën tuaj profesionale. Ne ju sigurojmë mundësinë dhe burimet e nevojshme, në mënyrë që ju ti përqëndroni totalisht energjitë dhe qëllimet tuaja në ndërtimin e një biznesi të shkëlqyer.



## NË BIZNES PËR VETE, POR JO I VETËM

# “Interneti po bëhet çdo ditë dhe më i rëndësishëm. Cila është teknologjia që do t’me ndihmojë mua në administrimin e zyrës time dhe shërbimet e listimeve?”



## Me RE/MAX ju nuk jeni

**vetëm**, sidomos kur flitet për teknologjinë e informacionit. RE/MAX ofron vizibilitet online si asnjë tjetër. Miliona njerëz vizitojnë faqet online të RE/MAX çdo ditë. Kur blerësit apo qeramarrësit interesohen për një pronë në cilindo shtet apo qytet të botës, faqja online i lidh ata drejtpërdrejt me Partnerin e Shitjes në rajonin përkatës pa komision referencë.

RE/MAX di që teknologjia nuk mund të zëvendesojë rolin e Partnerit të Shitjes, por ky i fundit mund ta përdor teknologjinë në avantazhin e tij për dokumentimin, transmetimin, këmbimin dhe përdorimin e informacioneve në kohë reale dhe mënyrën më efikase.

Për këtë arsye, RE/MAX ka krijuar një platformë online me shumë komponent që ndihmon Brokerat dhe Partnerët e Shitjes të jenë sa më produktiv në punën e tyre.

**iConnect.** Është one-stop-shop juaj për të gjitha nevojat administrative të zyrës franchise. Ju mund të bëheni pjesë e teknologjisë së RE/MAX vetëm me një të klikuar.

**iList.** Ky software i avancuar listimesh shërben për të dokumentuar dhe manaxhuar inventarin e pronave, të klasifikoni kontaktet dhe të ndiqni ecurinë e transaksioneve ekzistuese. Funkzioni **Buyer Match**, një nga veçoritë më të spikatura të teknologjisë tonë, ju jep mundësinë të kryeni kërkimin e një prone në databazen Rajonale e cila përputhet me kërkesat specifike të klientit. Nëse kjo pronë mungon në databaze në kohën e kërkimit dhe në një moment të dytë listohet nga një Partner Shitje i RE/MAX, atëherë sistemi lajmëron në mënyrë automatike Partnerin e Shitjes dhe klientin për mundësinë më të re në treg duke i shërbyer kështu ekskluzivisht interesave të klientit.

**iBroker.** Është një software që ndihmon pronarët e zyrave franchise dhe Partnerët e Shitjes të përcaktojnë qartë objektivat e punës së tyre dhe monitorojnë vijueshmërinë e aktivitetit të zyrës mbi baza të qëndrueshme.

**RE/MAX Advantage.** Është platforma më e re multimediale e RE/MAX Europe dhe unike në të gjithë industrinë e ndërmetesimit të pasurive të paluajtshme. Kjo platformë ju vendos larg nga konkurrenca dhe lehtëson së tepërmi aktivitetit tuaj profesional. Për më tepër informacion vizitoni faqen [www.remadvantage.eu](http://www.remadvantage.eu)



# TEKNOLOGJI E FJALËS SË FUNDIT

# “Unë dua të operoj në një rrjet që bashkëpunon dhe interesohem të di më shumë se ç’farë mundësish më krijon RE/MAX për të komunikuar me kolegët e mi lokal dhe ata që ndodhen jashtë Shqipërisë?”

**Rrjeti i RE/MAX** është shumë kompleks, dhe të tilla janë dhe burimet që ne ofrojmë për t’ju lidhur me kolegët tuaj brënda dhe jashtë rajonit.

**iConnect** është një platformë gjithëpërfshirëse për të gjitha aktivitetet tuaja online. Me iConnect ju keni mundësinë të aksesoni të gjitha pronat e listuara nga agjentët e RE/MAX, të kërkonit për një zyrë pranë jush apo thjeshtë të mësoni më shumë për profilin profesional të kolegëve tuaj

**Mainstreet**, intraneti i vetëm ndërkombëtar për antarët e RE/MAX ju afron shumë pranë 7.000 zyrave të RE/MAX dhe 110.000 Partnerëve të Shitjes në mbarë botën. Menjëherë sapo të hapni një zyrë Franchise, ne ju mundësojmë akses të personalizuar në të gjitha portalet e komunikimit brenda rrjetit RE/MAX.

#### **Evente Rajonale dhe Ndërkombëtare.**

Zyra Rajonale e RE/MAX Albania thërret në takime periodike Brokerat dhe Partnerët e Shitjes për të ndarë me ta sfidat dhe mundësitë e reja të biznesit. RE/MAX Europe dhe International,

nga ana tjetër, organizojnë konferenca dhe konventa vjetore të cilat ndiqen nga mijëra pjesëmarrës, anëtar të rrjetit. Mundësi e shkëlqyer për të ndërtuar marrëdhënie profesionale e miqësore me kolegët tuaj përtej kufirit. Gjithashtu, të ftuarit special, ekspert të industrisë së pasurive të paluajtshme ju prezantojnë me strategjitë dhe teknikat më të reja për t’ju shërbyer më mirë klientëve dhe për të gjeneruar më shumë të ardhura.

**Industria e pasurive të paluajtshme** është një industri tejet dinamike, ndaj dhe anëtarët e rrjetit RE/MAX e vlerësojnë rëndësinë e kontakteve dhe shkëmbimit të eksperiencave me kolegët e tyre për të promovuar veten dhe siguruar një pozicion konkurrues në treg.



# RRJET BASHKËPUNUES

# “A ofron RE/MAX mundësi specializimi në segmentin e pronave komerciale ose luksoze të tregut lokal?”



## RE/MAX COMMERCIAL

Në industrinë e pasurive të paluajtshme, RE/MAX zë një vend të veçantë përsa i përket numrit të praktikantëve të certifikuar komercial. Kjo nënkupton një bazë të konsiderueshme njohjesh dhe eksperiencash që përkthehen në rezultate të drejtëpërdrejta për anëtarët e rrjetit.

Në rrjetin RE/MAX, bëjnë pjesë më shumë se 3,000 praktikant komercial, 43 zyra RE/MAX Commercial dhe mbi 300 divizione që funksionojnë si njësi të pavarura brënda një zyre të përgjithshme RE/MAX në 22 vënde në mbarë botën.

Konsulentët komercial të rrjetit RE/MAX kanë konkluduar më shumë se 60 miliard dollar volum transaksionesh komerciale që prej fillimit të këtij shërbimi në vitin 2003. RE/MAX është një mbështetës historik i Institutit për Çertifikimin e Ndërmjësuesve Profesionist në investimet komerciale.

RE/MAX Commercial ofron edukim të specializuar për konsulentët komercial, tipologji të veçantë website-sh, materiale marketimi dhe simpoziume të përvitshme në mënyrë që konsulentët tanë të komunikojnë hapur me publikun si ekspert të vërtetë në tregun komerciale të pasurive të paluajtshme.

## RE/MAX COLLECTION

Shtëpitë luksoze kërkojnë vëmendje të veçantë. Me RE/MAX Collection Partnerët tanë të Shitjes mund ti shërbejnë ekskluzivisht klientëve të tyre të zgjedhur të cilët interesohen të blejnë ose shesin prona të një cilësie të veçantë.

Të gjitha materialet marketuese të tilla si: dizenjimi i hapsirës në web, kartvizitat, broshurat, logot dhe materialet outdoor në oborrin e shtëpisë janë ideuar me shumë kujdes nga specialistët e RE/MAX në mënyrë që listimi juaj luksoz të dalloj dukshëm nga ofertat e tjera të tregut.

Programi i RE/MAX Collection i mundëson Brokerave dhe Partnerëve të Shitjes një mori burimesh promocionale dhe trajnimesh të specializuara për të informuar dhe orientuar me korrektesi klientin për mundësit e investimit dhe manaxhimin e plotë të transaksionit deri në transeferimin përfundimtar të titullit të pronësisë.



# SPECIALIZOHUNI ME RE/MAX

# “Unë dua të bëhem pjesë e rrjetit të madh RE/MAX dhe të ndërtoj një biznes të suksesshëm. Kush është hapi vijues që duhet të ndjek?”

**Ky është momenti i duhur** për tu bërë pjesë e rrjetit që ju ndihmon të ndërtoni një biznes jetëgjatë e të sigurt. Shpresojmë që informacioni i paraqitur në fletët e kësaj broshure t’ju ndihmojë të merrni një vendim kritik lidhur me angazhimin tuaj në tregun e pasurive të paluajtshme. Këtu ju prezantojmë një panoramë të përgjithshme të cilësisë së shërbimeve që e identifikojnë RE/MAX si një nga kompanitë më të suksesshme në botë.

Në RE/MAX, ju jeni prioriteti jonë. Qëllimet tuaja janë qëllimet tona. Kjo është arsyeja përse ne punojmë fort për t’ju ofruar mbështetjen dhe shërbimet që ju nevojiten për të qëndruar lider në tregun e pasurive të paluajtshme.

Ne mirëpresim mundësinë për të diskutuar më hollësisht me ju mjetet dhe veçoritë e modelit tonë të biznesit. Besojmë se po të njiheni më nga afër me RE/MAX, do të kuptoni që kjo është zgjedhja më e mirë që mund të bëni për të ardhmen tuaj.

A nuk është avantazh të punosh me më të mirët?



## KOHA PËR T’JU BASHKUAR RE/MAX



# RE/MAX NËPËR BOTË!



## Americans

Argentina	2004
Belize	2001
Brazil	2009
Canada	1977
Chile	2003
Colombia	2009
Costa Rica	1995
Ecuador	2008
El Salvador	2006
Guatemala	2002
Honduras	1995
Mexico	1992
Nicaragua	1998
Panama	2005
Peru	2009
United States	1973
Uruguay	2008
Venezuela	1998

## Caribbean

Antigua and Barbuda	1994
Aruba	2003
Bahamas	2009
Bonaire	2003
Cayman Islands	1991
Curacao	2008
Dominican Republic	1993
Grenada	1994
Jamaica	2009
Puerto Rico	1992
St. Barthelemy	2004
St. Kitts and Nevis	1996
St. Lucia	2007
St. Martin/St. Martin	1993
Trinidad and Tobago	2008
Turks and Caicos	1993
U.S. Virgin Islands	1988

## Europe

Albania	2008
Austria	1999
Belgium	2001
Bulgaria	2006
Croatia	2004
Czech Republic	2005
England	1997
Estonia	2005
Finland	2006
France	2005
Germany	1995
Greece	1995
Hungary	2006
Iceland	2000
Ireland	1997
Israel	1995
Italy	1995
Latvia	2006
Lithuania	2006
Luxembourg	2001
Republic of Macedonia	2008
Malta	2003
Montenegro	2007
Netherlands	1998
Northen Ireland	1997
Norway	2000
Poland	2006
Portugal	1999
Rumania	2006
Scotland	1997
Serbia	2007
Slovakia	2005
Slovenia	2007
Spain	1994
Sweden	2000
Switzerland	1999
Turkey	1997
United Kingdom	1997
Wales	2001

## Middle East

Bahrain	2004
Kuwait	2007
Oman	2008
Qatar	2009
Saudi Arabia	2002
United Arab Emirates	2004
Lebanon	2010

## Africa

South Africa	1994
Botswana	2003
Mauritius	2002
Morocco	2009
Mozambique	2006
Namibia	2002
Zambia	2002
Tanzania	2010
Zimbabwe	2010

## Asia/Pacific

Australia	1996
Guam	2001
India	2009
New Zealand	2003
Singapore	1997

June 2010

©2010 RE/MAX, LLC. All rights reserved.  
Each Office Independently Owned and Operated. 100842

# TASHMË EDHE NË SHQIPËRI!

PËR INFORMACION TË MËTEJSHËM KONTAKTONI  
INFO@REMAX-ALBANIA.COM



# “Sektori më i madh i pasurive të paluajtshme në Europë”



## Prisni Larmi.

Miliona klientë në mbarë botën mund të identifikojnë lehtësisht RE/MAX si lider të tregut të pasurive të paluajtshme. Nëse flitet për blerjen ose për marrjen me qera të një apartamenti, shtëpie, trualli apo ambienti tregtar, me RE/MAX ju do gëzoni më të mirën e shërbimit imobiliar.

**Askush nuk shet më shumë pasuri të paluajtshme se RE/MAX**

## Avantazhet tuaja

- RE/MAX ofron këshilla të drejta dhe profesionale
- RE/MAX ofron shërbime dhe zgjidhje inteligjente për nevojat tuaja
- RE/MAX është lider i besuar në treg

Agjent të Shkëlqyer, Rezultate të Shkëlqera®

